

FORMULARI 2 – VENDIM PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHETJE
FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE / PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE



Në bazë të nenit 53 paragrafi 3 dhe të nenit 80B të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin 05/L-007, të nenit 8, paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, dhe të Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 25.05.2016, dhe nenit 10 të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për Projekte / Propozime të organizatave jo-qeveritare në fushën e Kulturës dhe të Sportit.

I.

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për Projektet / Programet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Gjakovës, kodi ekonomik subvencione, në kuadër të programit / nën programit Planit vjetor i mbështetjes financiare publike për Organizatat Jo-Qeveritare.

II.

1. Mjetet e përmendura në nenin I. do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III.

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike;
2. Udhëzimet për aplikantët;
3. Formularët e aplikimit;
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit;

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta;
4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);
5. Forma e deklarates së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit.

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (kk.rks-gov.net/gjakove/).

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pas të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e Projekteve / Programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Komunës së Gjakovës.


VII.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Data: 09.03.2020

Saramita Hyseni Maloku, Drejtore e Kulturës dhe Sportit të Komunës së Gjakovës
Nënshkrimi:





1. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe të Sportit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DKRS-së së Komunës së Gjakovës i cili i dedikohet Kulturës dhe të Sportit.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

a. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.

b. Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në zbatimin e aktiviteteve të Kulturës dhe të Sportit përmes aktiviteteve si me poshtë:

✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile me qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Kulturës dhe Sportit tek shoqëria civile e më gjerë;

✓ Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe nxitjen e aktiviteteve në kuadër të Kulturës dhe Sportit.

✓ Aktivitetet e organizimeve të Manifestimeve të ndryshme Kulturore dhe Sportive;

✓ Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Kulturore dhe Sportive.

✓ Avancimin dhe promovimin i vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës dhe Sportit.

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet individuale është 250.00 Euro.

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, duke filluar nga data **09.03.2020** dhe përfundon me datën: **27.03.2020**

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vitë para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe të Sportit.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës i OJQ-së, dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofertuesit të mbështetjes financiare (**kk.rks-gov.net/gjakove/**).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve / programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e Kulturës dhe Sportit në Komunën e Gjakovës.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së.

Gjakovë, 09.03.2020





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)

10 / 2020 – zyrtare

Date: 09.03.2020

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të rregullores 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 8 paragrafi 3.2, shpall këtë :

THIRRJE PUBLIKE

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ju njofton se ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve, të publikuar me datë: 09.03.2020, me titull:

- Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.
- Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit.

DKRS, fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar, duhen t'i plotësojnë këto kriteret, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë),
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë).
3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë).
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë).
5. Njohja e metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën e thirrjes publike (20 pikë).
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë)
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pikë).

Afati i aplikimit është shtatë ditë kalendarike 09.03.2020 deri 17.03.2020

Dokumentet e kërkuara: Diploma mbi kualifikimin e noterizuar, Diplomat e lëshura nga Institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje); Vërtetimi për përvojën e punës (kopje); Certifikata që nuk jeni nën hetime (origjinal); Dokumenti i identifikimit (kopje). Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Me respekt!



KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 381 422 591
kk.rks-gov.net/gjakove/